



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

Nr. _____ Prot.

Patos, më __.01.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 30.01.2024

Nga: “Albpetrol” sha – Patos

Drejtuar: OE “AZ Trading” shpk me NUIS L81515016F, me adresë: Tiranë, Njësia Administrative nr.7, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla G&P, Kati 1, Njesia nr.13

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-91971-12-22-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje eskavatorë, jo më të vegjël se 9 ton, 2 (dy) copë”

Kohëzgjatja e kontratës është 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 105 datë 29 Dhjetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “AZ Trading” shpk me NUIS L81515016F, me vlerë oferte në total 34,840,000 lekë (pa TVSH).
2. Operatori Ekonomik “ELI” shpk me NUIS K71920502I, me vlerë oferte në total 31,000,000 lekë (pa TVSH).
3. Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” shpk me NUIS L52317046G, me vlerë oferte në total 35,900,000 lekë (pa TVSH).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “ELI” shpk me NUIS K71920502I për arsyet e mëposhtme:
 - *Specifikimet teknike në skedën teknike të paraqitur nga OE, nga firma prodhuese për eskavatorët objekt prokurimi, nuk përputhen me karakteristikat teknike dhe specifikimet teknike të kerkuara nga AK.*
 - *OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt e kerkuar. OE nuk ka paraqitur një dokument që verteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. OE ka hartuar një deklaratë garancie në të cilin deklaron se distributori TEKNOXGROUP shpk i cili autorizon OE të paraqitet në këtë tender, është*

dealer i kompanisë CAT (CATERPILLAR). Kërkesa e AK është: “Ne rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që verteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij“. Pra deklarata/autorizimi duhet të jetë e hartuar nga prodhuesi për distributorin me të gjithë elementët e sipërpërmendur, pasi vetëm kështu KVO mund të gjykojë për një bashkëpunim të mundshëm, vlerësim i cili bazohet vetëm mbi paraqitjen e dokumentacionit fakt.

- Operatori ekonomik “MUHOPLUS LTD” shpk me NUIS L52317046G për arsytet e mëposhtme:
 - OE nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.
 - OE nuk ka paraqitur furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt e kerkuar.
 - OE nuk ka paraqitur kataloge teknike/skede teknike, nga firma prodhuese për eskavatorët objekt prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “AZ Trading” shpk me NUIS L81515016F, me adresë: Tiranë, Njësia Administrative nr.7, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla G&P, Kati 1, Njesia nr.13, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 34,840,000 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik të “Albpetrol” sha, rruga Fier – Patos km 7, Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe tenderi do të anulohet, siç parashikohet në nenet 83 dhe 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO X

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eltar DEDA